



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:023514

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05584668

C-IV.-14-4873

Ankuesi :

F R nga f.sh Ll i K.Lipjan.
Përfaqësuar nga av.L D nga Graçanica.

Kundër

E paditura :

N.SH “Ferronikeli”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”,
Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Murat Hulaj, me dt.17 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET PJESRISHTË**, ankesa e ankuesit si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN052-0033 dt.30 maj 2014, ashtu qe
- 2. DETYROHET** e paditura AKP, që ankuesit F R në emër të kompensimit për paga të papaguara për periudhën nga data 09.03.1993 e gjerë me dt. 28.02.1998, t'i paguaj shumen 9,832.57¹€ + **10,262.79²€**, si dhe kamatën prej 10% në shumë prej 2.009 €, e qe ne total shuma e përgjithshëm kapë vlerën prej **22,104,36 €** për pages, pjesa e tjetër përtej shumës se gjykuar, refuzohet si e pa bazuar.
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2, të diapozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit pasi qe ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm

¹ Te njohur sipas Vendimin te Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN052-0033 dt.30 maj 2014.

² Shuma shtesë e aprovuar nga DHPGJS.

4. Aprovohet pjesërisht si e bazuar, kërkesa e paditësit për rimbursimin e shpenzimeve procedurale dhe atë në shumën prej 150 euro.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.20 qershor 2014, ankuesi përmes të autorizuarit të tij, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, të Gjykatës Supreme (DHPGJS), ankesë kundër Vendimit nr.PRN052-0033 datë 30 maj 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara në shumë prej 26,430.13€, nga NSH "Ferronikeli"(në likuidim). Ankuesit me këtë vendim i ishte aprovuar shuma prej 9,832.57 si dhe shuma prej 1,266.77€, kurse i ishte refuzuar shuma prej 10,262.79€ si shumë e pa justifikuar. Ankuesi pohoi se e kundërshton vendimin e AL për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të së drejtës materiale. Ka shtuar se kërkesa për kompensim është bërë sipas ekspertizës financiare të dt.20.05.2006, me aplikimin e kursit përkatës nga ekspertit financiar, e që shuma e pagave të papaguara arrin shumën 25,080.33€. AL e anashkalon marrëveshjen gjyqësore dhe bënë përllogaritje të re. Ka kërkuar që gjykata të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj vendimin e AL. I ka kërkuar shpenzimet gjyqësore në shumë prej 344.66€ si dhe 150€ për ekspertizën financiare. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Ekspertizën financiare nr.020/2006 dt.20.05.2006, Dëftesë nr.029/06 dt.29.05.2006, Gjetjet dhe vështrimin e përgjithshëm të ekspertit financiar me konstatimet dhe mendimin përfundimtar se bashku në pasqyrën e përllogaritjes së revalorizimit dinarik të shumës 170,125.74 din YU, prej dt.01.03.1998 e gjer me dt. 23.03.1999 dhe kamatat ligjore prej 01.09.1999 gjer me dt. 20.05.2006, konvertimi nga D Y në D dhe nga D në Euro, sipas kurseve zyrtare në referim të Aktgjykimit P1.nr. 394/93 përkatësisht Aktvendimit gjyqësor N.nr.739/97, për llogari tani paditësit F R e po ashtu pasqyrën revalorizuse të shpenzimeve procedurale prej dt. 13.04.1998 gjer me dt. 23.03.1999 dhe kamatat ligjore nga data prej dt. 01.09.1999 e gjer me dt. 20.05.2006, Deklaratë e ekspertit financiar R B dt.11.03.1998, Formular i kërkesës për likuidim, Kërkesë për përmbushje të detyrimit drejtuar AKP-së, të dt.26 nëntor 2004, Kërkesë për përmbushje të detyrimit drejtuar AKP-së, dt.05 qershor 2006, Kërkesa për përmbarrimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komonale në Prishtinë P1.nr.394/93 dt.29.09.1997 e bërë me dt.05.12.1997 nr.05.12.1997, Propozim për ekzekutim drejtuar Gjykatës Komonale në Prishtinë dt.23.05.1998, Procesverbal P1.br.739/97 dt.13.04.1998, Aktgjykim P1.br.394/93 dt.29.09.1997.

E paditura parashtroi përgjigje në ankesë me dt.14 tetor 2016, në të cilën pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. Vendimi i AL nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se nuk ka asnjë bazë për ta shfuqizuar. Ka shtuar se ndryshe nga sa pretendon parashtrues AL në marrjen e vendimit është bazuar në marrëveshjen gjyqësore dhe se Autoriteti i Likuidimit (AL), ka bërë konvertimin bazuar në të dhënat e gjetura në Bankën Qendrore të Serbisë. Pala kundërshtare nuk mund ta kompensojë ankuesin për ekspertizën financiare e cila është e gabuar dhe e pa bazuar. Mbrojtjes i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar, listën e konvertimit të valutës.

Me dt.01 nëntor 2016, i autorizuari i paditësit ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen e të paditurës, me të cilën e ka kundërshtuar të njëjtën. Kurse pala e paditur ka paraqitur kundërpërgjigjen e saj me dt.18 nëntor 2016.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i Autoritetit të Likuidimit(AL).

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: “*Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës*”. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: “*I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit*”.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi me të paditurën kishin lidhur marrëveshje gjyqësore për kompensim të pagave të pa paguara me Aktgjykimin P1.nr.394/93 dt.29.09.1997. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e shumës të cilën NSH-ja, është dashur që të ia kompensoj ankuesit. E paditura e kundërshton kërkesën e

ankuesit duke pretenduar se shuma të cilën e kërkon ankuesi nuk është shuma për të cilën është arritur marrëveshja gjyqësore. E paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesi, bazën e kërkesës së tij e mbështet në provat e dorëzuara me ankesë dhe atë: Kopjen e vendimit të kundërshtuar, Ekspertizën financiare nr.020/2006 dt.20.05.2006, Dëftesë nr.029/06 dt.29.05.2006 si gjetje, Rishikim, Opinion dhe Deklaratë e ekspertit financiar R B dt.11.03.1998, Formular i kërkesës për likuidim, Kërkesë për përmbushje të detyrimit drejtuar AKP dt.26 nëntor 2004, Kërkesë për përmbushje të detyrimit drejtuar AKP dt.05 qershor 2006, Kërkesa për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë P1.nr.394/93 dt.29.09.1997 e bërë me dt.05.12.1997 nr.05.12.1997, Propozim për ekzekutim drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë dt.23.05.1998, Procesverbal P1.br.739/97 dt.13.04.1998, Aktgjykim P1.br.394/93 dt.29.09.1997.

Nga ekspertiza financiare nr.020/2006 dt.20.05.2006 e punuar nga Agjencinë për ekspertiza revizion kontabilitet “Ekspertiza”, pas konvertimit të detyrimit dinari në shumë prej 170,125.75 Din i takon shuma prej 25,935.47€.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara provat e elaboruara më lart, për të arritur në përfundim se NSH-ja, i ka mbetur borxh pagat e pa paguara. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë relevante për të vërtetuar faktin se NSH-ja, i ka mbetur borxh ankuesit apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Ndaj parashtruesit të ankesës nuk caktohet taksë gjyqësore ngase të njëjtën e ka paguar më dt.28.09.2022 në shumë prej 20 euro, sipas Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/2017 të datës 1 maj 2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Vendimin për rimbosimin e pjesshëm të shpenzimeve procedurale të kërkuar nga paditësi gjykata e mori si të bazuar për shumën prej 150 euro, ngase paditësi ka bashkangjitur dëshminë-dëftesën nr.029/2006 të dt.29.05.2006, në emër të pagesës së ekspertizës së ekspertit financiar, ndërsa për shpenzimet gjyqësore në shumë prej 344.66€ i refuzoi refuzohet në mungesë të provave të besueshme –faktuarve apo diq të ngjashme.

Refuzimin e shpenzimeve procedurale të krijuara kinse nga pala paditëse gjykata –DHPGJS, e mori si e pa bazuar në mungesë provash për ta provuar kërkesën e pretenduar në shumat

e kërkuara dhe atë: shpenzimet gjyqësore në shumë prej 344.66€ si dhe 150€ për ekspertizën financiare ngase nuk ka ndoni faktur të bashkangjitur mbi këto kërkesa.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,
Murat Hulaj